



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori i Specializuar k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Vendosi: Trupi Gjykses II

Gjykatës Çarls L. Smith III, Kryegjykatës

Gjykatës Kristof Barte

Gjykatës Ginel Metro

Gjykatës Fergal Gejnor, gjykatës rezervë

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 19 dhjetor 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Urdhër mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për Përsheptimin e Afateve për
Parashtrime lidhur me Kërkesën F02785**

Prokurores së Specializuar
Kimbërli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit
Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave
Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit
Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit
Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit
Venkatesvari Alagenda

TRUPI GJYKUES II ("Trupi Gjykues"), në bazë të neneve 21 dhe 40(2) e (6) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullave 9 dhe 116 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Rregullorja"), lëshon këtë urdhër.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 1 dhjetor 2023, pas kërkesës së Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS"),¹ Trupi Gjykues modifikoi kushtet e paraburgimit për Hashim Thaçin ("z. Thaçi"), Kadri Veselin ("z. Veseli") dhe Rexhep Selimin ("z. Selimi") (bashkërisht "tre të akuzuarit") ("kushtet e modifikuara të paraburgimit") ("Vendimi mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit").²
2. Më 9 shkurt 2024, Trupi Gjykues lëshoi vendim me udhëzime në bazë të Vendimit mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit.³
3. Më 22 mars 2024, pas kërkesës së Mbrojtjes së z. Selimi ("Mbrojtja e Selimit"),⁴ Trupi Gjykues lëshoi vendim ku refuzoi kërkesën për rishikim gjyqësor të

¹ F01933, Prokurorja e Specializuar, *Kërkesë Urgjente e Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit*, 17 nëntor 2023, konfidenciale, me Shtojcat 1-5, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 22 nëntor 2023, F01933/RED.

² F01977, Trupi Gjykues, *Vendim i Mëtejshëm mbi Kërkesën Urgjente të Prokurorisë për Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për Hashim Thaçin, Kadri Veselin dhe Rexhep Selimin*, 1 dhjetor 2023, para. 51-53, 55-60, 62-76, 84(c).

³ F02115, Trupi Gjykues, *Vendim mbi Njoftimin e Zyrës Administrative në lidhje me Masat Mbrojtëse të Urdhëruara nga Gjykata dhe Kërkesën për Udhëzime në bazë të Vendimit F01977*, 9 shkurt 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F02115/RED.

⁴ F02160/A01, Administratorja, *Shtojca 1 e Përcjelljes së Kërkesës së Rexhep Selimit për Rishikim Gjyqësor të Vendimit të Administratores mbi Kërkesën për Rishikim*, 1 mars 2024, konfidenciale dhe *ex parte*. Administratorja ia përcolli Trupit Gjykues Kërkesën e z. Selimi për Rishikim Gjyqësor më 1 mars 2024 (shih F02160, Administratorja, *Përcjellje e Kërkesës së Rexhep Selimit për Rishikim Gjyqësor të Vendimit të Administratores mbi Kërkesën për Rishikim*, 1 mars 2024, konfidenciale dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-5, konfidenciale dhe *ex parte*).

vendimit të Administratores në zbatim të Vendimit mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit.⁵

4. Më 13 dhjetor 2024, Mbrojtja e Selimit kërkoi që Trupi Gjykses të ndryshojë Vendimin mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit pasi masat e përcaktuara në të nuk janë më të domosdoshme apo proporcionale; ndikojnë ndjeshëm në mundësinë e z. Selimi për të mbajtur kontaktet e nevojshme me familjen; si dhe krijojnë një barrë të madhe mbi stafin e objektit të paraburgimit të Dhomave të Specializuara ("Kërkesa").⁶ Mbrojtja e Selimit kërkoi gjithashtu përsheptimin e afateve për parashtrimet, ku ZPS-ja të dorëzojë përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur dhe që Trupi Gjykses ta miratojë masën juridike të kërkuar para pushimit të pritshëm të Gjykatës në mënyrë që z. Selimi t'i përfitojë privilegjet shtesë gjatë periudhës së pushimit të Gjykatës.⁷

5. Më 19 dhjetor 2024, pas korrespondencës *inter partes* ndërmjet palëve dhe pjesëmarrësve, Trupi Gjykses lëshoi urdhër për pezullimin e afateve për të gjitha parashtrimet, me përjashtim të rishikimeve të paraburgimit.⁸

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në bazë të nenit 40(2) e (6) dhe rregullës 116, Trupi Gjykses merr vazhdimisht të gjitha masat e nevojshme për lehtësimin e kryerjes së drejtë e të shpejtë të gjykimit dhe për mbrojtjen e të akuzuarve, dëshmitarëve dhe viktimave.

7. Në bazë të rregullës 9(5)(a), nëse i tregohen arsye të vlefshme, ose *proprio*

⁵ F02194, Trupi Gjykses, *Vendim mbi Kërkesën e Rexhep Selimit për Rishikim Gjyqësor të Vendimit të Administratores mbi Rishikimin* ("Vendimi mbi Kërkesën e z. Selimi për Rishikim Gjyqësor"), 22 mars 2024.

⁶ F02785, Mbrojtja, *Kërkesë e Mbrojtjes së Selimit drejtuar Trupit Gjykses për Ndryshimin e Vendimit F01977*, 13 dhjetor 2025, para. 1, 3-4, 38, me Shtojcat 1-2, konfidenciale.

⁷ Kërkesa, para. 37.

⁸ F02800, Trupi Gjykses, *Urdhër për Zgjatjen e Afateve për Parashtrime dhe Rishikimin e Transkripteve të Seancave Private gjatë Periudhës së Pushimit Dimëror të Gjykatës* ("Urdhri për Zgjatjen e Afateve"), 19 dhjetor 2024.

motu, paneli mund të zgjasë ose shkurtojë afatet e përcaktuara prej kësaj Rregulloreje apo prej panelit.

8. Në bazë të rregullës 9(6), kur nuk i shkaktohet padrejtësi palës kundërshtuese, lejohet që vendimi në lidhje me një mocion për ndryshimin e afateve të merret duke mos i dhënë palës kundërshtuese mundësinë e shprehjes së mendimit.

III. DISKUTIM

9. Trupi Gjykues vë në dukje se, me kërkesë dhe pajtim të palëve dhe pjesëmarrësve, urdhëroi, me disa përjashtime të kufizuara, pezullimin e afateve për dorëzimin e parashtrimeve dhe rishikimin e transkripteve të seancave private gjatë periudhës së pushimit dimëror të Gjykatës.⁹ Megjithatë, Trupi Gjykues do ta shqyrtojë kërkesën e Mbrojtjes së Selimit për përshpejtimin e afateve për dorëzimin e parashtrimeve në përgjigje të Kërkesës.

10. Fillimisht, Trupi Gjykues thekson se pajtohet me Mbrojtjen e Selimit se Trupi Gjykues duhet ta rishikojë Vendimin mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit për të përcaktuar nëse kushtet e vendosura me atë vendim mbeten të domosdoshme dhe proporcionale.¹⁰

11. Megjithatë, Trupi Gjykues është i mendimit se ky rishikim duhet të jetë tërësisht i bazuar në informacion dhe i plotë. Në këtë kontekst, Trupi Gjykues thekson se Vendimi mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit modifikoi kushtet e paraburgimit për tre të akuzuarit,¹¹ jo vetëm për z. Selimi. Rrjedhimisht, për ta kryer këtë rishikim, Trupi Gjykues e gjykon të nevojshme të dëgjojë edhe

⁹ Periudha e pushimit dimëror të Gjykatës zgjat nga e hëna, 23 dhjetor 2024, deri të premten, 10 janar 2025. KSCPR-2023, F00002, Kryetarja, Periudhat e Pushimit të Gjykatës për Vitin 2024, 25 shtator 2023; *Shih* Urdhrin për Zgjatjen e Afateve, para. 10, 13-14, 15(b).

¹⁰ Kërkesa, para. 1, 4, 38; *Shih gjithashtu* Vendimin mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit, para. 77; Vendimin mbi Kërkesën e z. Selimi për Rishikim Gjyqësor, para. 51.

¹¹ Vendimi mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit, para. 51-53, 55-60, 62-76, 84(c)

Mbrojtjen e z. Thaçi dhe Mbrojtjen e z. Veseli. Gjithashtu, është e nevojshme të dëgjojë edhe parashtrimet e ZPS-së dhe Administratores.

12. Për më tepër, Trupi Gjykues rithekson se kushtet e paraburgimit të tre të akuzuarve u modifikuan për të parandaluar nxjerrjen e palejueshme të informacionit konfidencial, përfshirë të identiteteve të dëshmitarëve të mbrojtur, dhe për të garantuar integritetin e procesit gjyqësor.¹² Rrjedhimisht, për rishikimin e Vendimit mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit, Trupit Gjykues do t'i duhet të vlerësojë nëse kushtet e modifikuara të paraburgimit mbeten të domosdoshme dhe proporcionale, përfshirë nëse mbrohet mirëqenia e dëshmitarëve dhe viktimave në rast të modifikimit të kushteve të paraburgimit.¹³

13. Trupi Gjykues vlerëson se nuk është e përshtatshme që ky rishikim të kryhet brenda një kohe të shkurtër, pa dëgjuar parashtrimet e plota dhe të bazuara në informacion të të gjitha palëve dhe pjesëmarrësve. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues konstaton se Mbrojtja e Selimit nuk ka treguar arsye të vlefshme për përshpejtimin e afateve për dorëzimin e parashtrimeve ndaj Kërkesës, pasi në afat të shkurtuar Trupi Gjykues nuk do të mund të merrte parashtrime të plota dhe të bazuara në informacion para shqyrtimit të themelësisë së Kërkesës. Mbi këtë bazë, Trupi Gjykues rrëzon kërkesën për përshpejtimin e afateve për parashtrime.

14. Trupi Gjykues vlerëson se ZPS-së nuk i shkaktohet dëm nga marrja e vendimit mbi kërkesën për përshpejtimin e afateve për parashtrime pa i dhënë ZPS-së mundësinë për t'u shprehur, pasi Trupi Gjykues ka rrëzuar kërkesën.

15. Meqenëse konstatoi se Vendimi mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit duhet të rishikohet pas marrjes së parashtrimeve të plota dhe të bazuara në informacion nga të gjitha palët dhe pjesëmarrësit, Trupi Gjykues e gjykon të përshtatshme të caktojë afatet për dorëzimin e parashtrimeve në lidhje me këtë

¹² Vendimin mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit, para. 30.

¹³ Neni 23(1); rregulla 80(1).

rishikim. Rrjedhimisht, Trupi Gjykses: (i) urdhëron Mbrojtjen e z. Thaçi dhe Mbrojtjen e z. Veseli të dorëzojnë parashtrime nëse kushtet e paraburgimit, të modifikuara me Vendimin mbi Modifikimin e Kushteve të Paraburgimit, mbeten të domosdoshme dhe proporcionale, në qoftë se dëshirojnë, deri **të mërkurën, 22 janar 2025**; (ii) urdhëron ZPS-në të dorëzojë përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesës, si dhe ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes së z. Thaçi dhe Mbrojtjes së z. Veseli, në qoftë se dëshiron, deri **të hënën, 3 shkurt 2025**; (iii) urdhëron Administratoren të dorëzojë përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesës, si dhe ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes së z. Thaçi dhe Mbrojtjes së z. Veseli, në qoftë se dëshiron, jo më vonë se **të hënën, 3 shkurt 2025**; dhe (iv) urdhëron ekipet e Mbrojtjes së tre të akuzuarve të dorëzojnë kundërpërgjigjet, në qoftë se dëshirojnë, deri **të hënën, 10 shkurt 2025**.

IV. VENDIM

16. Për arsyet e sipërpërmendura, Trupi Gjykses:

- a) **RRËZON** Kërkesën për përshpejtimin e afateve për parashtrime;
- b) **URDHËRON** Mbrojtjen e z. Thaçi dhe Mbrojtjen e z. Veseli të dorëzojnë parashtrime nëse kushtet e modifikuara të paraburgimit mbeten të domosdoshme dhe proporcionale, në qoftë se dëshirojnë, deri **të mërkurën, 22 janar 2025**;
- c) **URDHËRON** ZPS-në të dorëzojë përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesës, si dhe ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes së z. Thaçi dhe Mbrojtjes së z. Veseli, në qoftë se dëshiron, deri **të hënën, 3 shkurt 2025**;
- d) **URDHËRON** Administratoren të dorëzojë përgjigje përmbledhëse ndaj Kërkesës, si dhe ndaj parashtrimeve të Mbrojtjes së z. Thaçi dhe Mbrojtjes së z. Veseli, në qoftë se dëshiron, deri **të hënën, 3 shkurt 2025**;
- e) **URDHËRON** ekipet e Mbrojtjes së tre të akuzuarve të dorëzojnë

kundërpërgjigjet, në qoftë se dëshirojnë, deri **të hënën, 10 shkurt 2025;**
dhe

- f) **SHTYN** marrjen e vendimit mbi THEMELËSINË e Kërkesës deri pas përfundimit të afateve të caktuara për dorëzimin e parashtrimeve të lartpërmendura.

/nënshkrimi/

Gjykatës Çarls L. Smith, III

Kryegjykatës

E enjte, 19 dhjetor 2024

Në Hagë, Holandë.